



PLAN AKSIONAR 2025

Këshilli lokal ekonomik-social – (KLES) i
Komunës së Kërçovës

October 30



ЛОКАЛЕН ЕКОНОМСКО-СОЦИЈАЛЕН СОВЕТ



1. KËSHILLI LOKAL EKONOMIK-SOCIAL

Këshilli Lokal Ekonomik - Social - (KLES) i Komunës së Kërçovës është themeluar më 27 qershor 2016 si organ i përbashkët këshillues dhe konsultativ i Komunës së Kërçovës, i themeluar nga Komuna e Kërçovës, Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë, Sindikata e Maqedonisë - Zyra Sindikale Kërçovë dhe Konfederata e Sindikatave të Lira të Maqedonisë, në kuadër të projektit Promovimi i Dialogut Social, i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE), dhe implementohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP).

Funksioni i KLES Kërçovë është vendosja e dialogut demokratik dhe social për arritjen e paqes sociale të qëndrueshme dhe stabile dhe përfshirjen aktive të të gjithë partnerëve social në procesin e vendimmarrjes për çështjet më të rëndësishme me rëndësi ekonomike dhe sociale për zhvillim të komunitetit lokal, duke përfshirë çështjen e forcimit të lidhjeve thelbësore ndërmjet nevojave të tregut të punës të përcaktuara nga subjektet afariste dhe aftësive që zhvillohen tek të rinjtë nëpërmjet sistemit arsimor, si dhe parandalimin dhe zgjidhjen paqësore të punëve dhe konflikteve të tjera në komunitetin lokal.

Këshilli Lokal Ekonomik - Social i Komunës së Kërçovës i shqyrton çështjet, i jep mendime, propozime dhe rekomandime Këshillit të Komunës së Kërçovës dhe organeve tjera për çështje nga sfera ekonomike dhe sociale.

Propozim Plani Aksionar i KLES për vitin 2025 është përgatitur nga anëtarët e KLES Kërçovë si një platformë që përshkruan aktivitetet që duhet të zbatohen në vitin 2025.

Propozim plan Aksionar i Këshillit lokal ekonomik-social (KLES) i Komunës së Kërçovës për vitin 2025

Kërçovë , Tetor 2025

Hyrje

Ky propozim – Plan Aksionar i KLES i Komunës së Kërçovës për vitin 2025 është përgatitur nga anëtarët e KLES Kërçovë si një platformë e cila përshkruan aktivitetet që ky trup këshillues, në bashkëpunim me institucionet që e kanë formuar në vitin 2016 dhe palët e tjera të interesit, do të synojnë që të realizohet në vitin 2025.

Objektivat, aktivitetet dhe detyrat e planifikuara

Objektivi 1: Promovimi i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe të rinjve në zhvillimin e komunës së Kërçovës

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Indikatori	Përgjegjës për aktivitetin	Korniza kohore	Buxheti
1. Organizimi i aktiviteteve promovuese për masat qeveritare dhe programet e punësimit në fushën e arsimit joformal (promovimi i ligjit për praktikën, garancia për të rinjtë, qendrat e karrierës në shkollat e mesme, qendrat arsimore për specializim dhe certifikimin e të punësuarve, etj.)	Informim më i mirë i qytetarëve për masat dhe programet e qeverisë për punësim dhe programet në fushën e arsimit joformal	Të paktën 2 sfaqje publike për promovimin e masave dhe programeve të qeverisë për punësim dhe programe në fushën e arsimit joformal	Komuna e Kërçovës, APRM; Organizatat civile; Sektori i biznesit	Janar-Mars viti 2025	10.000 denar
2. Futja e arsimit të dyfishtë dhe promovimi i shkollës së mesme – drejtimet profesionale - Përmirësimi i cilësisë së arsimit formal profesional	Rritja e informacionit të qytetarëve dhe nxënësve për mundësitë e shkollave profesionale Trajnimi i nxënësve dhe lidhja e punëdhënësve dhe nxënësve me qëllim rritjen e punësimit të profesionistëve të rinj	Numri i nxënësve dhe 1 sfaqje Trajnimi i 100 nxënësve të shkollave të mesme profesionale për profesione të përshtatshme në kompani private, punëdhënës potencial.	Anëtarë të KLES, Përfaqësues nga Mirko Mileski dhe Drita, Univerziteti i punës	Prill - Mars viti 2025	120.000 den

Objektivi 2: Promovimi i krijimit të vendeve të punës cilësore në komunë**Aktiviteti: Inicimi i aktiviteteve për përfshirjen aktive të punëdhënësve dhe subjekteve të tjera në hapjen e vendeve të reja të punës**

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Indikatori	Përgjegjës për aktivitetin	Korniza kohore	Buxheti
1. Organizimi i forumit të punëdhënësve dhe komunitetin biznesit	Organizimi i forumit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, sjellja e konkluzioneve dhe përcaktimi/paraqitja e propozimeve me masa dhe politika të përshtatshme në Këshillin e Komunës, për shqyrtim dhe miratim.	Më së paku një forum, Lista e nxënësve, Fotografi, Raporte	Komuna e Kërçovës, APRM; Organizatat civile; Sektori i biznesit	Септември – Октомври 2025 година	150.000 денари
2. Ditë të hapura për mundësi punësimi në nivel lokal - Panairi i karrierës	Qasje për publikun, veçanërisht për të rinjtë, e të gjitha informacioneve për vendet e lira të punës në komunë dhe në komunitetin e biznesit	Ftesa për të gjitha institucionet dhe komunitetin e biznesit, Lista e pjesëmarrjes, foto	Anëtarë të KLES, Komuniteti i bizneseve të biznesit, Përfaqësues nga Mirko Mileski dhe Drita, Univerziteti i punës	Maj viti 2025	120.000 den

Objektivi 3: Promovimi i ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kolektive/individuale të punës

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Indikatori	Përgjegjës për aktivitetin	Korniza kohore	Buxheti
<p>1. Vendosija e komunikimit me ndërmjetësuesit me qëllim përgatitjen e informacionit për vëllimin dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kolektive/individuale të punës</p>	<p>Informimi i plotë i KLES me mundësitë e ndërmjetësimit në drejtim të lehtësimit të punësimit</p> <p>Promovimi i ndërmjetësimit si një mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve individuale dhe kolektive të punës</p> <p>Të gjitha informacionet e publikuara në portalin e internetit KLES</p>	<p>Takim dhe komunikimi me ndërmjetësuesit</p>	<p>Komuna e Kërçovës, Organizatrat civile; Sektori i biznesit</p>	<p>Shtator - Tetor 2025</p>	<p>10.000 denar</p>
<p>2. Kontribut në përmirësimin dhe realizimin e të drejtave të punonjësve</p>	<p>Kontrata të nënshkruara për orar të denjë pune dhe mbrojtje në punë në më shumë institucione në nivel lokal, punëtorë të edukuar përmes forumeve të organizuara dhe dialogëve të hapur</p>	<p>Kontrata të nënshkruara, takime të zhvilluara, komunikim i rregullt</p>	<p>Anëtarë të KLES; Sektori i Biznesit, „SSM,,, „KSS,, „ORM,,</p>	<p>Gjatë vitit 2025</p>	<p>10.000 denar</p>

Objektivi 4: Organizimi i trajnimeve interne për anëtarët e KLES Kërçovë dhe vendosja e bashkëpunimit me KLES të tjera vendore dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e përvojave

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Indikatori	Përgjegjës për aktivitetin	Korniza kohore	Buxheti
1. Trajnime për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të KLES, për avancimin e punës së KLES Kërçovë	Mbajtja e trajnimeve në përputhje me planin dhe rritja e kapaciteteve të KLES për të arritur qëllimet në promovimin e aktiviteteve të KLES.	Dy trajnime	KLES Kërçovë dhe Komuna e Kërçovës, Sektori i Biznesit	Gjatë vitit 2025	120.000 den
2. Vizitë pune e KLES në një vend tjetër evropian dhe shkëmbim eksperiencash dhe projektsh	Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira të dobishme për përmirësimin e punës së KLES	Një vizitë	Antarët e KLES	Gjatë vitit 2025	300.000 den

Nr. _____

Data _____

Kërçovë

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri